

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7822  
E shtunë, 29 qershor 2024  
Çmimi 0.50 €

## Tkurret popullsia e Shqipërisë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# HOXHAIJ: ASKUSH S'U BESON MË PËRRALLAVE TË KURTIT.



Ish-ministri i Punëve të Jashtme, njëherësh nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosova mund të kthehet në binarë vetëm me qeverisjen e PDK-së.

Ai ka theksuar se askush më nuk u beson përrallave të Albin Kurtit, i cili, sipas tij, gjatë katër viteve të fundit nuk mbahet mend për një reformë apo përparim të caktuar. Hoxhaj e

ka quajtur veprim të kotë një afrim në mes të PDK-së dhe LV-së për bashkëpunim në të ardhmen. "Kemi dallime marramendëse, të mëdha", ka deklaruar Hoxhaj


## OPINION

AGJENTËT E BIA-s, NË QEVERI, KUVEND DHE SHOOËRI CIVILE F. 9

Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA



## AKTUALE



BLINKEN: IZRAELI NUK I KA PËRMBUSHUR TË GJITHA ANGAZHIMET HUMANITARE NË RRIPIIN E GAZËS F. 2

HAPET PISHINA E GËRMISË F. 6

KOSOVA PËRFITON 37.2 MILIONË EURO DHE 2 MILIONË DOLLARË GRANT PËR AVANÇIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE F. 5

## EKONOMI



LIDERI I SIGURIMEVE 'SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP' SHËNON 20-VJETORIN E AKTIVITETIT NË KOSOVË F. 8

## SPORT



'EURO 2024', SONTE PËRBALLEN ZVICËR - ITALI DHE GJERMANI - DANIMARKË F. 10

## BIDENI DHE TRUMPI SHKËMBEJNË KRITIKA NË DEBATIN PRESIDENCIAL

F. 3



## ROHDE: IA KEMI BËRË TË QARTË KURTIT QË DUHET TË LËVIZË DREJT ASOCIACIONIT

F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Polonia pritet të nënshkruajë marrëveshje të sigurisë me Ukrainën para samitit të NATO-s

VARSHAVË, 28 QERSHOR - Kryeministri polak Donald Tusk tha të premtën se është pothuajse e sigurt se Polonia do të nënshkruajë marrëveshje dypalëshe të sigurisë me Ukrainën para samitit të NATO-s që mbahet muajin e ardhshëm në Uashington. Tusk tha se para samitit të NATO-s në Uashington, i cili nis më 9 korrik, do të ketë bisedime në Varshavë me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky. "Unë, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, duhet të vendosim patjetër se si mund të vazhdojmë ta ndihmojmë

Ukrainën, por ne nuk mund ta dobësojmë mbrojtjen e Polonisë", tha Tusk. "Gjasat janë 99 për qind që ne do ta nënshkruajmë këtë marrëveshje me presidentin Zelensky [para samitit]", shtoi ai. Tusk shtoi se marrëveshja është praktikisht "e kryer" dhe se kanë mbetur vetëm edhe disa hollësi për t'u qartësuar. Bashkimi Evropian dhe dy prej vendeve të saj anëtare, Lituania dhe Estonia, nënshkruan marrëveshje të sigurisë me presidentin ukrainas Zelensky gjatë samitit në Bruksel të enjten.



## Blinken: Izraeli nuk i ka përmbushur të gjitha angazhimet humanitare në Rripin e Gazës



WASHINGTON, 28 QERSHOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Izraeli ka marrë hapa për përshtetimin e dërgesave të ndihmave humanitare në Rripin e Gazës, por duhet t'i zbatojë plotësisht angazhimet e tij për ta siguruar shpërndarjen e sigurt të ndihmave për civilët në nevojë. Sekretari Blinken theksoi se ai e kishte ngritur këtë çështje në takimin me ministrin izraelit të mbrojtjes Yoav Gallant në Uashington në fillim të kësaj jave dhe i kishte thënë atij se "sfidat urgjente" që duhen trajtuar janë dërgimi i ndihmave

në zonat ku njerëzit kanë më së shumti nevojë, përfshirë ushqim, ujë, ilaçe dhe artikuj të tjerë bazë. "Gjatë javës së kaluar ne kemi punuar për t'i zgjidhur sfidat urgjente, që po e bëjnë të vështirë dhënien e ndihmës së nevojshme humanitare për banorët e Gazës, të cilët kanë aq shumë nevojë për të, veçanërisht kur bëhet fjalë për sigurinë e dërgesave humanitare", tha sekretari i Shtetit, Antony Blinken, përpara se të takojë me koordinatoren e OKB-së për ndihmat në Rripin e Gazës, Sigrid Kaag, në Departamentin e Shtetit. "Unë i

ngrita këto shqetësime në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me ministrin izraelit të Mbrojtjes, Yoav Gallant, i cili ishte këtu vetëm disa ditë më parë dhe mendoj se kemi parë gjatë dy ditëve të fundit disa përparime në Izrael në përpjekjet për të zbatuar një pjesë të angazhimeve të diskutuara në takim", tha Blinken. "Është mirë dhe e rëndësishme që Izraeli po i trajton këto nevoja shumë konkrete, por ato duhet të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Nuk ka kohë për të humbur".

## Rusia paralajmëron masa të paspecifikuara ndaj dronëve amerikanë mbi Detin e Zi

MOSKË, 28 QERSHOR - Ministria e Mbrojtjes e Rusisë i urdhëroi zyrtarët e vet ta përgatisin një "përgjigje" ndaj dronëve amerikanë që fluturojnë mbi Detin e Zi, tha kjo Ministri të premtën. Ministria ruse tha se ka një "intensitet të rritur" së voni të dronëve amerikanë mbi Detin e Zi, duke shtuar se ata "mbledhin informata dhe objektiva për armët precize me të cilat ushtria ukrainase furnizohet nga aleatët perëndimorë për të kryer sulme ndaj objekteve ruse". "Kjo tregon për një përfshirje të rritur të ShBA-së dhe vendeve të NATO-s në konfliktin në Ukrainë duke ia mbajtur anën regjimit të Kievit", tha ajo në një komunikatë. Ajo theksoi se "fluturime të tilla e rrisin dukshëm mundësinë e incidenteve me përfshirjen e avionëve luftarakë rusë, gjë që e rrit rrezikun për konfrontim të drejtpërdrejtë mes aleancës dhe Federatës Ruse". "Anëtarët e

NATO-s do ta mbajnë përgjegjësinë për këtë", shtoi ajo. Ministria theksoi se ministri i Mbrojtjes Andrei Belousov e ka urdhëruar Shtabin e Përgjithshëm të "bëjë propozime për masat si përgjigje ndaj provokimeve". Uashingtoni dhe Moska janë konfrontuar edhe më parë rreth dronëve amerikanë në Detin e Zi. Në një incident më 2023, një avion luftarak rus e dëmtoi një dron amerikan atje, duke bërë që ai të rrëzohej. Përsëritja e një konfrontimi të tillë mund t'i rrisë tensionet edhe më shumë rreth luftës në Ukrainë. Në mars 2023, një avion luftarak Su-27 i Forcave Ajrore Ruse e dëmtoi një dron amerikan MQ-9, duke e rrëzuar në Detin e Zi. Ai incident shënoi konfrontimin e parë të drejtpërdrejtë mes forcave ruse dhe atyre amerikane prej Luftës së Ftohtë. Rusia i ka deklaruar zona të



ndaluar për fluturime pjesë të gjera afër Krimesë. Prej se Rusia e aneksoi jashtëligjshëm Gadishullin e Krimesë më 2014 dhe shumë kohë para se ta niste pushtimin e Ukrainës më 2022, Moska e ka akuzuar Uashingtonin se avionë vëzhgues

amerikanë kanë fluturuar shumë pranë kufijve të saj, duke i shpërfillur paralajmërimet e Rusisë. Deklarata e së premtës vjen pas një sulmi ukrainas me raketa amerikane ATACMS në Sevastopol në fundjavë, ku u

vrarë katër njerëz dhe u plagosën rreth 150, sipas autoriteteve ruse. Zyrtarët rusë pretendojnë se ShBA-ja u përfshi drejtpërdrejt në atë sulm duke i dhënë Ukrainës informata për objektivat ruse dhe u zotua se do të ndërmarrë masa hakmarrëse.



## Hoxhaj: Askush s'u beson më përrallave të Kurtit

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka një interpretim më ndryshe rreth përafrimit në mes të PDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje, i cili është "kurorëzuar" me një darkë në mes të Albin Kurtit dhe Memli Krasniqit.

Hoxhaj është treguar "aspak diplomatik", duke qenë krejt i drejtpërdrejtë për këtë çështje. Në botëkuptimin e Hoxhajt, çfarëdo përpjekje për përafrimin në mes të PDK-së dhe LV-së është e kotë.

Duke folur për këtë temë në "RTV 21", Hoxhaj ka vlerësuar se ka shumë dallime në mes të këtyre dy partive, gjë e cila e bën përafrimin të zorshëm. "Do të ishte e kotë një përpjekje dhe një afrim i Partisë Demokratike të Kosovës me Lëvizjen Vetëvendosje në mënyrën se si Lëvizja Vetëvendosje i sheh politikën, shtetin, shoqërinë, kulturën dhe mediet, pra kemi dallime marramendëse të mëdha", ka thënë Hoxhaj.

Gjatë intervistës, Hoxhaj ka qenë radikalisht kundër kryeministrit Kurti. Sipas tij, askush nuk u beson më përrallave të Kurtit. "Kosova mund të kthehet në binarë vetëm në qeverisje të PDK-së. Askush më nuk u beson përrallave të Albin



Kurtit i cili gjatë katër viteve të fundit nuk mbahet mend për një reformë, për një koncept, progres e rezultat të vetëm", ka thënë Hoxhaj.

Madje qeverisjen me Kurtin dhe LV-në, Hoxhaj e sheh si të dëmshme. "Interes i Kosovës është ne të mos mbesim shpejtësia e fundit e zhvillimit në rajon si kemi mbetur këto katër

vitet e fundit. Për këtë unë mendoj se më nuk ka hapësirë që të ketë koordinim para se të mbahen zgjedhjet. Ne duhet të shkojmë në zgjedhje si subjekte të ndara politike, por për këtë duhet të shtrohet pyetja se cila duhet të jetë platforma e partive politike opozitare pas zgjedhjeve meqenëse unë e shoh një qeverisje me Kurtin të dëmshme çdo

subjekt politik që mund ta bëjë", ka thënë Hoxhaj.

Duke folur për zgjedhjet e parakohshme, Hoxhaj ka vlerësuar se PDK-ja është e gatshme të shkojë në zgjedhje. "PDK-ja është e gatshme që çdoherë të shkojë në zgjedhje. Gjithashtu, është e gatshme që sa më herët ta largojë Kurtin nga pushteti. PDK-ja është e gatshme që me subjektet e tjera

në opozitë ta rikthejë Kosovën në binarë", ka thënë Hoxhaj.

Ish-kryetari i PDK-së ka folur edhe për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Drafti të dërgohet në Kushtetuese dhe mandej fillon procesi i themelimit të Asociacionit, por Serbia të bllokoi kudo ndërkombëtarisht, Serbia të krijon telashe në veri. Unë mendoj se ne edhe me partnerët tanë duhet të flasim se si duket harta më e plotë e asaj se çfarë po ndodh në rajon. Nëse BE-ja pas zgjedhjeve të fundit në BE e shpall të vdekur politikën e zgjerimit në vitet 2025/ 26. 28./30 nuk ndodh asgjë me zgjerimin evropian, unë e shoh të pamundur që të ketë një Ballkan me stabil dhe të sigurt, dhe një Serbi e cila ka një interes që të lëvizë drejt njohjes së Kosovës. Prandaj ne duhet të bisedojmë me partnerët tanë se cilat janë obligimet e partnerëve tanë në raport me shtetndërtimin e Kosovës, por unë mendoj që ne nuk duhet ta zbatojmë themelimin e Asociacionit pa një ndërlidhjeje të tij me njohje të Kosovës, me anëtarësim të Kosovës në NATO dhe me një rrugë të qartë të anëtarësimit tonë në BE", ka thënë Hoxhaj.

## Tkurret popullsia e Shqipërisë

TIRANË, 28 QERSHOR - Shqipëria ka aktualisht 2 milionë e 204 mijë e 113 banorë. Shifra u bë publike nga Instituti i Statistikave dhe, krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2011, rezultoi që shteti ka 419 mijë e 831 banorë më pak. Ndërkaq, më 2001 numri i popullsisë së Shqipërisë ishte 3 milionë 69 mijë e 275 banorë.

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, numri i familjeve është 755 950 dhe një familje ka mesatarisht 3.2 anëtarë.

Ndërsa, numri i popullsisë ka rënë thajse 17 për qind, teksa numri i shtëpive është rritur në 70 000. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2023, numri i shtëpive ishte 1 milion e 82 mijë e 529, ndërkaq më 2011 ishin 1 milion e 12 mijë e 400 shtëpi.



Drejtoresha e INSTAT-it, Elsa Dhuli, tha për mediet se këto të dhëna do t'u shërbejnë jo vetëm institucioneve, por edhe studiuesve dhe bizneseve. "Analiza dhe studime tematike do të kryhen për fusha të ndryshme të jetës. Këto analiza do të jenë për përdoruesit një burim informacioni për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë shoqërinë. Hartuesit e politikave, vendimmarrësit, studiuesit, bizneset, mund t'i përdorin për planifikimin zhvillimor, analizën e dukurive demografike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe zbatimin e tyre në praktikë në dobi të shoqërisë sonë", tha Dhuli.

Regjistrimi i popullsisë ofron të dhëna edhe në lidhje me shtetësinë dhe në Shqipëri, 99.4 për qind janë shqiptarë. Si shtetas grekë janë deklaruar 2 348 qytetarë, egjiptianë 12 375 dhe 13 507 nuk kanë dashur të deklarohen.

Sa i përket besimit fetar, Shqipëria rezultoi me shumicë myslimane, me mbi 1.1 milion banorë, rreth 200 000 banorë janë deklaruar si katolikë, ndërsa 173 000 si besimtarë të fesë ortodokse. Rreth 244 331 kanë zgjedhur të mos përgjigjen në pyetjen se cilës fe i përkasin. Bashkimi Evropian ka dhënë 4.8 milionë euro grante për INSTAT-in për të mbështetur këtë proces. Për regjistrimin e popullsisë u angazhuan 7 500 persona. Ky është regjistrimi i dymbëdhjetë i popullsisë në Shqipëri.

## Kurti: Serbia e shfaqti përsëri armiqësinë ndaj paqes dhe pajtimit

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka kritikuar vendimin e autoriteteve serbe për ndalimin e mbajtjes së festivalit "Mirëdita, dobar dan" të enjten në Beograd, duke thënë se Serbia ua ofroi skenën "grupeve huligane" në vend se t'ua linte artistëve. "Fatkeqësisht, Serbia e shfaqti përsëri armiqësinë e saj të paepur ndaj çdo gjëje që ka të

bëjë me paqe dhe pajtim", shkroi Kurti në "X" pak pas mesnatës të enjten.


Festivali "Mirëdita, dobar dan", që promovon bashkëpunimin kulturor në mes të Kosovës dhe Serbisë, u ndalua me urdhër të Ministrisë së Brendshme të Serbisë, më 27 qershor, pak para hapjes së planifikuar të tij në Beograd.

"Pasi refuzoi përsëri ta

nënshkruajë Marrëveshjen Bazë, e cila u ndërmjetësua nga BE-ja dhe mbështetet nga ShBA-ja, Serbia e ndaloi të enjten edhe një iniciativë të sponsorizuar nga BE-ja, 'Mirëdita, dobar dan', tha Kurti, i cili i paraqiti të mërkurën në Bruksel tri kushte për angazhimin e mëtejshëm në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.







# Bideni dhe Trumpi shkëmbejnë kritika në debatin presidencial

**WASHINGTON, 28 QERSHOR** - Presidenti demokrat Joe Biden dhe rivali i tij republikan, Donald Trump, kritikuan ashpër njëri-tjetrin mbi çështjen e ekonomisë, abortin, imigracionin dhe politikën e jashtme gjatë mandateve të tyre në debatin e tyre të enjten, duke u dhënë votuesve një mundësi për të parë në debat kandidatët më të moshuar presidencialë në historinë e Shteteve të Bashkuara. Presidenti Biden është 81 vjeç, ndërsa ish-presidenti Trump 78 vjeç. Presidenti Biden fliste me zë të ngjirur dhe ngatërroi fjalët në disa raste gjatë debatit, ndërsa Trumpi e goditi atë me kritika të njëpasnjëshme, që përfshinin disa gjëra të pavërteta që i ka thënë shpesh, duke përfshirë pretendimet se emigrantët kanë sjellë një valë krimi dhe se demokratët mbështesin vrasjen e foshnjave. Dy zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë thanë se presidenti Biden ishte me grip.

## Ekonomia

Joe Bideni dhe Donald Trumpi bënë një numër gabimesh faktike në fillim të debatit të enjten në Atlanta. Presidenti Biden e filloi debatin me një gafë, duke pretenduar se kishte krijuar 15 000 vende pune. Numri i saktë është më shumë se 15 milionë vende të reja pune gjatë mandatit të tij, një nënvlerësim dramatik nga një kandidat, që po përpiqet ta rifitojë besimin e votuesve në aftësitë e tij për ta udhëhequr ekonominë e vendit. Bideni tha, gjithashtu, se “një dozë e insulinës kushton 15 dollarë tani, në krahasim me 400 dollarë”. Por, kostoja e insulinës për amerikanët e

moshuar, të cilët janë pjesë e programit të sigurimeve shëndetësore të qeverisë, është ulur në 35 dollarë bazuar në ligjin e pakësimit të inflacionit, të cilin Bideni e nënshkroi në vitin 2022. Kjo ulje e kostos së ilaçit të insulinës hyri në fuqi në vitin 2023, duke detyruar shumicën e kompanive të sigurimeve shëndetësore që ta ulin në 35 dollarë koston e ilaçit. Trumpi tha se ekonomia amerikane ishte gati të fillonte ta paguante borxhin e saj kombëtar përpara pandemisë së Covid-19, por deficitit buxhetor po rritej gjatë mandatit të Trumpit, sepse shkurtimi i taksave në vitin 2017, një ligj që e ka mbështetur ai, nuk ka ndihmuar në uljen e deficitit ashtu siç kishte premtuar ai. Trumpi trashëgoi një deficit buxhetor prej 585 miliardë dollarësh dhe ai u rrit në 984 miliardë dollarë më 2019, duke shënuar rritje mbi 3 trilionë dollarë vetëm më 2020 pas fillimit të pandemisë, sipas Zyrës së Menaxhimit të Buxhetit në Shtëpinë e Bardhë. Presidenti Biden nga mesi i debatit filloi të përqendrohej në sulmet ndaj Trumpit duke përmendur gjyqin në Nju-Jork, në të cilin Trumpi u shpall fajtor për fshehjen e pagesave për aktoren e filmave pornografikë Stormy Daniel për të mbajtur të fshehur një marrëdhënie seksuale me të. Presidenti Biden e quajti rivalin e tij republikan “një njeri të shpallur fajtor për një krim”. Ish-presidenti Trump u përgjigj duke përmendur gjyqin ndaj djalit të presidentit Joe Biden, Hunter Biden, në të cilin ai u shpall fajtor për akuzën se ka gënjyer në një formular për blerjen e një arme mbi historinë e përdorimit të drogës. I pyetur për sulmin ndaj Kapitolit

më 6 janar 2021 nga një turmë e mbështetësve të tij, ish-presidenti Trump u përgjigj se ai nuk ishte përgjegjës për protestën në Kapitol dhe pretendoi se shumë nga të arrestuarit ishin të pafajshëm. “Ky është presidenti më i keq në historinë amerikane. Ky njeri nuk e kupton demokracinë amerikane”, tha Bideni në përgjigje të këtyre komenteve të rivalit të tij republikan. Ish-presidenti Donald Trump u ankuar se emigrantët që po hyjnë në vend në mënyrë të paligjshme po strehohen në “hotele luksoze”, ndërsa veteranët e ushtrisë sonë janë në rrugë. Siç pritej, ai u përqendrua shumë në çështjen e krimeve të emigrantëve. Ai tha se emigrantët po vijnë në Shtetet e Bashkuara nga “institucionet mendore” dhe “azilet”. Ai nuk ka dhënë prova për këtë pretendim, të cilin e ka bërë shpesh në tubimet elektorale.

## Lufta Rusi - Ukrainë

“Ne jemi si një vend i pazhvilluar dhe kjo është e turpshme”, tha Trumpi në debatin televiziv në selinë e kanalit CNN në Atlanta. “Ne nuk respektohem më”, tha Trumpi, duke e fajësuar për këtë presidentin Biden. “Ata mendojnë se ne jemi budallenj”. Gjatë debatit, Bideni dhe Trumpi ishin dakord në kundërshtimin e kushteve të presidentit rus Vladimir Putin mbi përfundimin e luftës në Ukrainë. Por, Trumpi përsëriti pretendimet e tij se lufta nuk do të kishte filluar kurrë nëse ai do të kishte qenë president. “Nëse do të kishim një president të vërtetë, një president që respektohej nga Putini, ai nuk do ta kishte sulmuar kurrë Ukrainën”, tha Trumpi. Ai kritikoi presidentin Biden për

ndihmat e mëdha që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Kievit. “Vazhdoni, lëreni Putinin të hyjë në Ukrainë dhe pastaj në Poloni dhe vende të tjera. Shihni se çfarë ndodh atëherë. Ai nuk e ka idenë se çfarë po thotë”, tha presidenti Biden për Trumpin. Bideni tha se Trumpi do të tërhiqte Shtetet e Bashkuara nga NATO dhe do të rrezikonte një luftë në zgjerim. Dhe për udhëheqësin rus, presidenti Biden tha: “Fakti është se Putini është një kriminel luftë”.

## Lufta Izrael - Hamas

Një nga temat e politikës së jashtme në debat ishte edhe lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit në Rripin e Gazës. Trumpi kritikoi presidentin Biden për mënyrën se si e ka trajtuar luftën në Rripin e Gazës, duke thënë se Bideni “është bërë si një palestinez” për shkak të kërkesës së presidentit Biden që Izraeli të bëjë më shumë për t'i mbrojtur civilët në Gaza. Trumpi e ka kritikuar gjithashtu kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, duke thënë në një intervistë në prill se ai duhet ta kishte parandaluar sulmin e Hamasit në Izraelin jugor më 7 tetor. Presidenti Biden i hodhi poshtë kritikën se administrata e tij ka zvarritur dërgimin e disa llojeve të armëve në Izrael. “Ne po i ofrojmë Izraelit të gjitha armët që i nevojiten”, tha ai. Presidenti Biden përmendi propozimin e tij me tri faza për arritjen e një armëpushimi në mes të Izraelit dhe Hamasit, duke fajësuar grupin militant palestinez për mungesën e një marrëveshjeje armëpushimi. Trumpi e kundërshtoi këtë vlerësim duke thënë se “Izraeli është ai që e

ka kundërshtuar propozimin. Dhe ju duhet t'i lini izraelitët ta mbarojnë punën”, tha ai. Izraeli filloi një ofensivë të gjerë ushtarake në Rripin e Gazës pas sulmit të militantëve të Hamasit në Izraelin jugor më 7 tetor, në të cilin u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe u morën peng 250 të tjerë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Rripin e Gazës, të kontrolluar nga Hamasi, që Shtetet e Bashkuara e kanë shpallur organizatë terroriste, nga sulmet izraelite janë vrarë mbi 37 600 njerëz. Ministria e Shëndetësisë në Rripin e Gazës nuk bën dallim mes luftëtarëve dhe civilëve në raportet e saj mbi numrin e viktimave. Debatit ishte një shans për të dy kandidatët që të flisnin për planet dhe vizionin e tyre për vendin dhe t'i bindin votuesit e pavendosur. Në Atlanta të Xhorxhias, një shtet i pavendosur dhe i rëndësishëm për zgjedhjet presidenciale, ishin të pranishëm politikanë republikanë që janë në listën e kandidatëve për nënpresident, përfshirë senatorin nga Ohajo JD Vance, ish-gubernatorin e Dakotës së Veriut Daug Bergum, senatorin nga Karolina e Jugut Tim Scott dhe senatorin nga Florida Marco Rubio. I mbajtur mbi katër muaj përpara zgjedhjeve të 5 nëntorit, debati Biden - Trump ishte një nga debatet më të hershme presidenciale në ciklin katërvjeçar të zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara. Ai ishte një përsëritje e dy debateve të tyre të vitit 2020, që u mbajtën dy muaj para zgjedhjeve, në të cilat Bideni fitoi ndaj presidentit të atëhershëm Donald Trump. Debatit i ardhshëm mes presidentit Biden dhe ish-presidentit Trump është caktuar të mbahet më 10 shtator. (Voa)



# Kosova përfiton 37.2 milionë euro dhe 2 milionë dollarë grant për avancimin e shërbimeve shëndetësore

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, së bashku me drejtorin e Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë, Massimiliano Paolucci, kanë nënshkruar tri marrëveshje me vlerë totale prej 37.2 milionë eurosh dhe 2 milionë dollarë grant për forcimin e sistemit të shëndetësisë si dhe shërbimeve të edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë edhe ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, si dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia.

Në fjalën e tij hyrëse, ministri Murati theksoi se listës së nismave që janë duke u zbatuar aktualisht me Bankën Botërore e që për theks kanë mbështetjen për qytetarët, sot po i shtohen edhe tri marrëveshje të reja të cilat kanë për synim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve thelbësore

shëndetësore publike dhe atyre të edukimit të hershëm.

Ministri Vitia konsideroi se përmes projektit "Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë" adresohen prioritetet kryesore shëndetësore siç janë digjitalizimi shëndetësor, zhvillimi i blerjeve për shëndetësi si dhe menaxhimi i mbetjeve mjekësore. "Projekti për edukimin e hershëm u mundëson të gjithë fëmijëve mundësi të barabarta duke u ofruar qasje në arsim cilësor dhe edukim të hershëm", ka thënë ministrja Nagavci.

Ndërsa drejtori Paolucci ritheksoi vullnetin e Bankës Botërore që përmes bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës, të mbështetet popullsia më e cënueshme në Kosovë.

Të gjitha palët u shprehën të kënaqura me sukseset e projekteve të mëparshme duke thënë se sukcesi i projekteve të kaluara po rezulton me projekte të reja si këto që u nënshkruan.



## Parlamenti spanjoll refuzon nismën për njohjen e Kosovës

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Me 25 vota për, 293 kundër dhe 27 abstenime, ligjvënësit spanjollë kanë refuzuar një nismë për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Spanja.

Nisma është paraqitur para Parlamentit spanjoll nga partia Junts per Catalunya (Së bashku për Katalonjën), që udhëhiqet nga Carles Puigdemont, dhe disa ditë më parë u mbajt edhe një debat parlamentar për të.

Në letrën që kjo parti dorëzoi në Parlament ishte përmendur vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e

cila në vitin 2010 kishte deklaruar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Gjithashtu, ishte përmendur fakti se Kosova njihet nga më shumë se 100 shtete. "Refuzimi spanjoll për ta njohur një shtet që shfrytëzoi të drejtën legjitime për vetëvendosje është një pengesë për politikën evropiane të integritit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Dhe ky refuzim është një faktor destabilizues në këtë zonë, në një kontekst të shënuar nga lufta në

Ukrainë të cilën kjo pjesë e Evropës e përjeton me ankth të veçantë", thuhej në propozim. Spanja është një nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian që ende nuk njeh pavarësinë e Kosovës. Arsyeja kryesore për mosnjohjen e shtetit të Kosovës nga Spanja besohet se lidhet me qëndrimin spanjoll karshi aspiratave të rajonit verilindor të saj, Katalonjës, që të pavarësohet. Ky rajon ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme që të ndahet nga Spanja, ndërsa Madridi zyrtar e ka kundërshtuar ashpër këtë lëvizje.



## Rama nderon me mirënjohje humanistin Kastrati për ndërtimin e 23 banesave në Lezhë

Tiranë, 28 qershor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka dhënë mirënjohje kryetarit të Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, për kontributin e tij të posaçëm në ndërtimin e 23 banesave për familjet e prekura nga tërmeti në qytetin e Lezhës.

Kryeministri Rama ka publikuar në "Facebook" momentin e dhënies së mirënjohës dhe falënderimin për humanistin Halil Kastrati për ndërtimin e 23 banesave në

Lezhë.

Ndërsa kryetari i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, ka thënë se ishte i nderuar "të pranojë nga kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, mirënjohjen për aktivitetet tona në Shqipëri, në veçanti në qytetin e Lezhës". "Kjo mirënjohje, ashtu siç janë edhe shumë të tjera për ne, janë motivime për të vazhduar misionin tonë. Këtë vlerësim ua dedikoj të gjithë donatorëve të shoqatës sonë", ka shkruar Kastrati në "Facebook".



## “Bujqësia dhe blegtoria, degët më të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik në Malishevë”

MALISHEVË, 28 QERSHOR - Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në komunën e Malishevës, Sylë Dukolli, ka realizuar një vizitë në fshatin Bubël, ku ka takuar dy fermerë të njohur të zonës për ta parë nga afër punën dhe nevojat e tyre.



Gjatë kësaj vizite drejtori Dukolli ishte i shoqëruar nga zyrtarët përgjegjës të kësaj drejtorie. Ai theksoi se kjo vizitë është fillimi i një serie vizitash në të gjitha fshatrat e komunës së Malishevës, me qëllim të njohjes më të mirë me aktivitetet e bujqve dhe fermerëve dhe për identifikimin e nevojave të tyre për planifikimet buxhetore të vitit të ardhshëm.

Vizita filloi te blegtori Shaip Shabanaj, i cili zotëron rreth 270 dele dhe vazhdon traditën familjare të mbajtjes së deleve.

Drejtori Dukolli përgëzoi Shabanajn për punën e tij dhe shpjegoi se vitin e kaluar blegtorët janë mbështetur me nga 3 euro për dele.

Ai shtoi se synimi për vitin 2025 është të rritet kjo mbështetje.

Në vijim, Dukolli vizitoi bujkun Ahmet Rrahmanaj, ku u prit nga

djali i tij, Fazliu.

Familja Rrahmanaj ka mbi 30 ari serrë, 55 ari vresht, 16 hektarë grurë e misër, 1 hektar pemë dhe rreth 300 dele, dhi e lopë qumështore.

Fazli Rrahmanaj e njoftoi drejtorin me punën e gjithanshme të familjes së tij në bujqësi dhe blegtori. “Bujqësia dhe blegtoria janë degët më të qëndrueshme e zhvillimit ekonomik. Ne kemi nevojë për produkte vendore dhe për këtë qëllim, ne si drejtori dhe si qeveri komunale, jemi të interesuar ta zhvillojmë sa më shumë këtë sektor përmes përkrahjes konkrete për të gjithë bujqit dhe fermerët e komunës sonë”, ka theksuar Dukolli gjatë vizitës së tij në fshatin Bubël.

Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në përpjekjet për ta mbështetur dhe zhvilluar bujqësinë dhe blegtorinë në komunën e Malishevës.



## Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Rahovecit, KFOR-it dhe universiteteve në fushën e turizmit

RAHOVEC, 28 QERSHOR - Nënkryetari i komunës së Rahovecit, Fatmir Iska, ka pritur në takim zëvendëskomandantin e Rajonit Perëndim të KFOR-it, Besnik Fana, përfaqësues të KFOR-it

italian dhe LMT-së, me ç’rast ka pranuar letër falënderuese për bashkëpunimin e komunës së Rahovecit dhe KFOR-it.

Po ashtu, nënshkruan memorandum bashkëpunimi

ndërmjet komunës, KFOR-it dhe universiteteve: “Haxhi Zeka” në Pejë, “Ukshin Hoti” në Prizren dhe “Fehmi Agani” në Gjakovë, për organizimin dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit.

## Ambasadori italian takon kryetarin e Gjilanit



GJILAN, 28 QERSHOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu.

Në takim ata kanë diskutuar për të arriturat dhe prioritetet e komunës. “Biseduam për të arriturat tona, sfidat dhe

projektet e së ardhmes. U pajtuam që ta forcojmë mundësinë e bashkëpunimit”, tha kryetari Alban Hyseni. Ambasadori De Riu tha se pati kënaqësinë të takohet me kryetarin Hyseni për të diskutuar rreth sfidave dhe planeve të ardhshme të

komunës së Gjilanit.

Ambasadori premtoi mbështetje për komunën dhe për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit të frytshëm.

Ata eksploruan mënyra për ta forcuar partneritetin, duke filluar me theksimin më efektiv të kompanive dhe

investimeve italiane dhe duke theksuar rëndësinë e kulturës italiane.

Kryetari Hyseni dhe ambasadori De Riu vlerësuan nivelin e shkëlqyeshëm të bashkëpunimit të arritur deri më tash, duke shpresuar në vazhdimin e tij edhe më tej.



## Hapet pishina e Gërmisë

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se të premtën është hapur pishina publike e Gërmisë. “Ju informojmë se sot gjatë gjithë ditës hyrja do të jetë pa pagesë. Çmimet e hyrjes gjatë pesë ditëve të javës janë: Për të rritur: 4

euro; Për të vegjël: 2 euro. Në fundjavë janë këto çmime: Për të rritur: 5 euro, për të vegjël: 2 euro. Ejani dhe shijoni freskinë e pishinës sonë, ku ju presin ambiente të pastra dhe të sigurta për të gjithë familjen”, ka njoftuar komuna e Prishtinës.



## MKRS-ja nënshkruan marrëveshje me Kamenicën dhe Deçanin për dy projekte

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Ministria e Kulturës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me komunën e Kamenicës dhe atë të Deçanit. MKRS-ja ka njoftuar se në Hogosht të Kamenicës do të bëhet ndërtimi i stadiumit historik të KF Kika,

ndërsa në Deçan do të ndërtohet pishinë gjysmë olimpikë, të dyja të financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. “Me vendosmëri po konsolidojmë infrastrukturën sportive në gjithë vendin”, ka njoftuar MKRS-ja.



## Gjykata i dënon katër persona me burgim për përfshirje në vrasjen e Oliver Ivanoviqit

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë e shpalli të premtën aktgjykimin për rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit, duke i dënuar me burgim katër persona, ndërsa e liroi një tjetër.

Nedelko Spasojeviq, Marko Roshiq, Dragisha Markoviq dhe Zharko Jovanoviq u dënuan në total me 22 vjet e gjashtë muaj burgim, ndërsa Sillvana Arsoviq u lirua nga akuzat.

Derisa ende nuk dihet autori apo organizatori i vrasjes së ish-politikanit serb të Kosovës, katër të akuzuarit u dënuan për pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal që organizoi vrasjen e tij dhe për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Ivanoviq u vra më 16 janar të vitit 2018 para objektit të partisë së tij në Mitrovicë të Veriut.

Zyra për Kosovën në Qeverinë

serbe e cilësoi "skandaloz" aktgjykimin e gjykatës në Prishtinë "kundër katër serbëve, të cilët gjyqësori i [kryeministrit të Kosovës Albin] Kurti po përpiqet në çdo mënyrë t'i lidhë me vrasjen e Oliver Ivanoviqit". "[Aktgjykim] është i motivuar politikisht dhe i instruktuar për ta kriminalizuar edhe më tej popullin serb në Kosovë", tha ajo në një komunikatë.



## Rohde: Ia kemi bërë të qartë Kurtit që duhet të lëvizë drejt Asociacionit

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Takimet bilaterale të mërkurën në Bruksel përfunduan pa takim trepalësh. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vendosi tri kushte, kurse presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, insistoi sërish te pika e 'nxehtë' - Asociacioni.

Ambasadori gjerman Jorn Rohde ka thënë se nuk është e dobishme të ngarkohet dialogu. Rohde tha se Kosova duhet të angazhohet në mirëbesim dhe jo t'i tregohet palës tjetër dhe ndërmjetësuesit se çfarë të mendojnë e çfarë të bëjnë. "Dhe, kjo edhe e rrit nivelin e frustrimit në anën e ndërmjetësuesit; sepse na duhen aktorë që tregojnë një nivel minimal vullneti për të bërë kompromis", tha ai për Nacionalen.

Ambasadori i Gjermanisë foli edhe për Asociacionin dhe një deklaratë të vetën se është befasuar që Kurti ishte befasuar se Asociacioni ishte kusht për KiE.

"Ia kemi bërë shumë të qartë që



duhet lëvizje (drejt Asociacionit). Sepse kjo edhe nënvizon përkushtimin e Kosovës për të drejtat e pakicave. Sepse është edhe obligim. Po flasim këtu për obligim të

ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës nga 2015. Qeveritë s'kanë lëvizur drejt asaj; dhe kur ju doni të bëheni anëtare e një organizate siç është KiE-ja; e që në veçanti është e angazhuar për të drejtat

e pakicave, kjo është e rëndësishme. Dhe, përsëri, qeveritë vendosin me 2/3 të votave; e Gjermania e ka veç një votë, dhe ju keni diku 10 mosnjohës në KiE. Pra, është

sfidë t'i arrini këto vota dhe, në mënyrë që miqtë tuaj të votojnë për ju, por edhe vendet skeptike, ju duhet t'i bëni detyrat e shtëpisë. E Asociacioni nuk është bërë", ka theksuar Rohde.

## Festimi i Vidovdanit në Kosovë kalon pa incidente



PRISHTINË, 28 QERSHOR - Në Gazimestan, një monument historik rreth 10 kilometra larg kryeqytetit të Kosovës, Prishtinë, të premtën janë mbledhur disa qindra serbë nga Kosova, Serbia dhe vendet e rajonit për ta shënuar festën e Vidovdanit.

Kisha Ortodokse Serbe e ka shënuar këtë festë edhe në Gazimestan, si datë e përkujtimit të vuajtjeve të serbëve në betejën kundër ushtrisë turke në Kosovë në vitin 1389.

Policia e Kosovës është kujdesur

për sigurinë e kësaj feste, ndërsa të pranishëm kanë qenë edhe pjesëtarë të KFOR-it italian.

Përkujtimi i Vidovdanit ka shkuar pa incidente, por numri i vizitorëve ishte dukshëm më i ulët se në vitet e kaluara. Policia e Kosovës këtë vit nuk lejoi sjelljen e flamujve apo të ndonjë simboli tjetër, përveç atyre kishtarë.

Në vitet e kaluara ka pasur edhe arrestime për "nxitje të urrejtjes fetare dhe kombëtare".

Peshkopi i Rashkës-Prizrenit, Teodosije, ka thënë më herët se

autoritetet e Kosovës ia kanë ndaluar kreut të Kishës Ortodokse Serbe, patriarkut Porfirije, të vijë në Kosovë në Vidovdan.

Vizita iu ndalua edhe drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, për shkak të "deklaratave provokuese dhe propagandistike kundër Kosovës".

Vitin e kaluar Vidovdani nuk u festua në Gazimestan, vendin ku festohet tradicionalisht për shkak të përkeqësimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës.

## Oficerë të FSK-së diplomojnë në Akademinë Ushtarake kroate

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Me ceremoni shtetërore të organizuar në Akademinë e Mbrojtjes Kroate në Zagreb, me praninë e presidentit të Republikës së Kroacisë, Zoran Millanoviq, me sukses kanë diplomuar pjesëtarët e FSK-së. "Major Kreshnik Nimoni,

Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, kapiten Besim Dervoviq, Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Rreshterë i Parë Fahri Paloja, Shkolla e lartë e Nënoficerëve. Republika e Kroacisë në kuadër të bashkëpunimit

bilateral mbështet vazhdimisht ngritjen e kapaciteteve profesionale për oficerët e nënoficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke ofruar trajnime e shkollime profesionale dhe me standardet më të larta të edukimit", ka njoftuar FSK-ja.





# Lideri i sigurimeve 'Sigma Vienna Insurance Group' shënon 20-vjetorin e aktivitetit në Kosovë

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Drejtori ekzekutiv i "Sigma Vienna Insurance Group" në Kosovë, Genond Mesareja, ka thënë se "Sigma" ka mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës duke gërshetuar rrezikun e madh me një gamë të gjerë të produkteve të sigurimit. Sipas tij, kjo ka qenë vendimtare për investime të rëndësishme publike dhe private të bëra nga kompanitë vendore dhe ndërkombëtare. Mesareja ka theksuar se industria e sigurimeve po bëhet shumë e rëndësishme në

vërtetohet lehtësisht me numra. Vitin e kaluar Sigma VIG (Vienna Insurance Group) mbuloi rrezikun agregat maksimal në Kosovë prej 68 miliardë eurove, që do të thotë sa shtatë herë GDP-ja reale e Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se "Sigma" në Kosovë është lidere madhore. "Ne jemi adresë e njohur referente për organizatat ndërkombëtare, ambasadat, bizneset vendore dhe individët në Kosovë. Nëpërmjet politikave strikte dhe marrëveshjeve të risigurimit me një kompani sigurimesh të klasifikuar 'A-plus',



Kosovë, derisa pohoi se vitin e kaluar Sigma në Kosovë mbuloi rrezikun agregat maksimal në vlerë 68 miliardë euro ose shtatë herë më shumë se bruto prodhimi vendor real i Kosovës. "Gjatë vitit 'Sigma Vienna Insurance Group' ka mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës duke gërshetuar rrezikun e madh me një gamë të gjerë të produkteve të sigurimit. Kjo ka qenë vendimtare për investime të rëndësishme publike dhe private të bëra nga kompanitë vendore dhe grupet shumëkombëshe si Aeroporti koncesionar dhe Kompania e Energjisë Elektrike në Kosovë. Edhe pse Kosova është një vend në zhvillim, industria e sigurimeve po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Mund të



si dhe anëtarë të tjerë, ne kemi rritur kapacitetet tona mbuluese dhe kemi mbuluar me sukses rrezikun e madh në Kosovë. Çelësi për ndërtimin dhe mbajtjen e një biznesi të qëndrueshëm në Kosovë nuk është vetëm respektimi i legjislacionit, por edhe zbatimi me sukses i standardeve të larta të Vienna Insurance Group në vend. Kujdesi profesional, standardet e larta të nënshkrimit, pretendimet strikte kanë qenë politikat dhe rezervimi adekuat financiar për këto gjëra janë garancia më e mirë për t'i zvogëluar rreziqet e kompanisë dhe për ta respektuar plotësisht detyrimin tonë kontraktual ndaj klientëve tanë", është shprehur ai. Drejtori ekzekutiv i "Sigma"-s ka pohuar se do të vazhdojnë në rrugën e rritjes së qëndrueshme në Kosovë, me parimin ESG dhe do të mbetet pikë referimi për shërbimet cilësore të sigurimit në Kosovë.

Ndërsa drejtori i Bordit Mbikëqyrës të "Sigma Vienna Insurance Group", Peter Hofinger, ka shprehur admirimin e tij për punën e "Sigma"-s në Kosovë. Ai ka thënë se "Sigma" është një kompani e sigurimeve e themeluar 200 vjet më parë dhe se me idetë dhe synimet për të vazhduar edhe 200 vjetët e ardhshme. "Më duhet të them konkretisht për Kosovën se ka një admirim të plotë për punonjësit tanë, menaxhmentin tonë, duke pasur parasysh 20 vjetët e fundit në Kosovë që e pasojnë 12 vjetët e fundit më afër me gjithë këto luhate, pasiguri, paparashikueshmëri të zhvillimit të caktuar, ne kemi një kompani fantastike këtu, po fokusohemi te klientët, jemi në një biznes besimi, po japim një premtim, një premtim të cilin thjesht e kemi në letër. Njerëzit duhet të besojnë se ne do ta përmbushim detyrimin tonë dhe modeli i biznesit të sigurimeve

në fund të fundit është punë e njerëzve dhe njerëzit janë të suksesshëm në biznesin tonë. Prandaj, një falënderim shumë i madh për punonjësit tanë, falënderim shumë i madh për menaxhmentin tonë këtu, i cili është në gjendje në një mjedis jo gjithmonë të lehtë për ta çuar kompaninë tonë drejt suksesit", ka deklaruar Hofinger, duke shtuar se klientët janë të kënaqur me punën e tyre. Gjatë gjithë periudhës së operimit në tregun e Kosovës, "Sigma Vienna Insurance Group" - Dega Kosovë ka pasur rezultate evidente pozitive sidomos në aspektin e situatës së qëndrueshme financiare, plotësisht të nevojave të klientëve për produktet e sigurimit, rritjes së garancive dhe të besueshmërisë me mbështetjen e një rrjeti efikas risigurimi, bashkëpunimit të suksesshëm dhe korrekt me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë.





# Agjentët e BIA-s, në Qeveri, Kuvend dhe shoqëri civile



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

**Me kohë është dashur të ndahet shapi nga sheqeri:** Si të dyshuar për bashkëpunëtorë të BIA-s, së voni janë arrestuar tre shtetas të Kosovës - dy shqiptarë dhe një serb. Dolën disa përgjime dhe në debate u ndezën shkëndijat e "njohësve" të sigurisë, të zbulimit dhe të kundërzbulimit duke paraqitur një degëzim të BIA-s në Kosovë thujta më të fuqishëm se që do ta paraqiste vetë Serbia. Interesant se si burime të "sigurta" të burimeve citohen pikërisht ish-bashkëpunëtorët e UDB-së, trashëgimtarët politikë dhe kombëtarë të jugosllavëve dhe serbëve që paraardhësit e tyre qençe iu kanë shërbyer. Tash, mbetjet jugosllave dhe serbe që zotërojnë një hapësirë të rëndësishme mediale dhe të mendermethënë shoqërisë civile, në debate shesin mjegull me synim të qartë të zhvendosjes së vëmendjes nga arrestimet e fundit për veprimtari kundër rendit kushtetues. Njëri nga ta i cili po deklarohet se ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe të cilin e njoh që nga viti 1999 si shoqëruar dhe shërbyes i politikanëve serbë në Kosovë që kundërshtonin shtetin e Kosovës dhe që e vidhnin pamëshirshëm. Të gjithë këta ministra serbë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim kanë

përfunduar si të akuzuar dhe dënuar për korrupsion. Disa prej tyre janë strehuar në Serbi të cilës i kanë shërbyer për ta dëmtuar Kosovën. Të tillëve qençe iu ka shërbyer, ekskluzivisht për përfitime materiale, ku farë "ish ushtari i UÇK-së" që mbrëmë plasi bombën nga prapanica e tij bombastike se disa komandantë të UÇK-së qenkan pjesëtarë të BIA-s duke u nisur, pa asnjë dyshim nga shembulli personal. Duke bërë përpjekje poshtërisht të njollosë UÇK-në, beson se del më i besueshëm. Me injorancën e tij përpiket, duke krijuar një mjegullnajë, të krijojë situata se qenka njëfarë bashkëpunëtor i një shërbimi informativ të armatosur të një shërbimi të huaj kurse, për mendimin tim më e madhja që mund të jetë është se mund të jetë mbetje e kanalizimit të shërbimeve informative të garnizonit të parashutistëve të Nishit, me një nën bazë në Graçanicë ku ky farë agjenti ka punuar një kohë të gjatë. Para se të dalin në debate me këta bastardë shqipfolës, gazetarët dhe panelistët duhet të njoftohen për të kaluarën kriminale e jo të mbesin të hutuar para një injoranti që gjuan bomba mjegulle dhe bën zhurmë për ta mbuluar të

kaluarën e vet dhe bashkëpunëtorëve të BIA-s që çdo ditë e më tepër po bien në rrjetin e organeve ligjzbatuese të Kosovës. Ky farë mashtruesi nuk e ka hallin te ata që janë të arrestuar por te vetja e tij, lakun e ka afër. Në një shtet normal, prokuroria do të duhej urgjentisht të merrej me çiftët si ky dhe Limoza Kulari, i pari shkaku se paska shumë informata për komandantët e UÇK-së si agjentë të BIA-s, e dyta pse ka negociuar me një kriminel kundër veteranëve të UÇK-së. Përgjimet nuk merren si prova materiale por, nëse hetohen si duhet, krijojnë mundësi për prova materiale. Sot, askush nuk sulmohet më shumë se UÇK-ja, është rikthyer koha e horrave dhe kemi një ringjallje të fuqishme të mbetjeve jugosllave dhe serbe. Denoncimi i UÇK-së për krime luftime, Shtëpia e Verdhtë, trafikimi me organe, Gjykata Speciale burimin e kanë pikërisht në Kosovë, Beogradi e ka shfrytëzuar si brumë për gatimin e një gjelle të kripur me sajime falë argatëve të tyre bë Kosovë. Lufta e UÇK-së është e shenjtë, në mungesë të mbrojtjes institucionale duhet të mbrohet nga vet ata që e bënë

luftën, nga ata që sakrifkuan personalisht dhe familjarisht, në radhë të parë nga ish të burgosurit politikë. Është e paimagjinueshme të presim sqarim të raporteve me Serbinë në kohën kur nuk i kemi sqaruar raportet midis nesh. Pengjet në Gjykatën raciste të Hagës, jo që nuk mbrohen nga institucionet përkatëse por bëhen përpjekjet maksimale t'iu rëndohet situata deri në përgatitjen e dëshmitarëve të mbrojtur. Atyre iu vazhdohet paraburgimi në saje të deklaratave të disa anëtarëve të mendermethënë shoqërisë civile që janë bërë milionerë në saje të deklarimeve antikombëtare dhe shpifëse për llogari të Gjykatës Speciale raciste dhe të Serbisë. Ish të përndjekurit politikë dhe familjarët e tyre sot përndiqen brutalisht nga pasardhësit e paraardhësve të tyre që i shërbyen Jugosllavisë dhe Serbisë. Hetuesit në proceset e montuara kundër shqiptarëve të vrarë dhe të dënuar në ish armatën jugosllave sot zënë vend në institucione, sikur të ishin pasardhës të Hasan Prishtinës dhe Isa Boletinit. Patriotët dhe familjarët e tyre po largohen nga puna duke u zëvendësuar me ish-bashkëpunëtorë të okupatorëve

serbë. Në diplomaci kemi spastrim në baza kombëtare dhe patriotike, kontribuuesit për çlirim dhe liri po përjashtohen, kurse dhunuesit e lirisë dhe kontribuuesit e robërisë po emërohen ambasadorë dhe konsuj, sekretarë dhe diplomatë të karrierës. Hiena e shpërfytyruar si ministër i Kulturës ndjek kombëtarët, kurse favorizon antikombëtarët. Kështu me radhë.

**Besimi si pretekst për sajime:** Gjykata Speciale raciste, në bashkëpunim me disa bastardë vendorë, në përpjekje për kriminalizim të udhëheqësve kryesorë të luftës çlirimtare në Kosovë, shpallësve të pavarësisë dhe ndërtuesve të shtetit, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e futën urrejtjen fetare të myslimanëve ndaj katolikëve, këta të fundit si viktimë, por se u demantua nga vetë besimtarët katolikë shqiptarë. Bastardi i debatit luajtë të njëjtën lojë kine BIA financon disa xhami në Kosovë dhe kontrollon një pjesë të klerit mysliman. Kjo nuk po vlejka për kisha ortodokse dhe katolike e as për klerin ortodoks apo katolikë. Çfarë poshtërsie dhe qëllim i keq nga një i poshtër dhe i keq!





## 'Euro 2024', sonte përballen Zvicër - Itali dhe Gjermani - Danimarkë

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**BERLIN, 28 QERSHOR** - Kombëtarja e Zvicrës, e udhëhequr nga kapiteni Granit Xhaka sonte (e shtunë), do të përballen me Italinë në raundin e 16-të në "Euro 2024". "Hapi i parë është bërë. Ne po presim me padurim raundin tjetër dhe kundërshtarët tanë të ardhshëm. Shpresoj që të gjithë të kenë pak më shumë respekt për Zvicrën tani", ka thënë Granit Xhaka, duke aluduar në paraqitjen superiore ndaj Gjermanisë. Në fakt, Zvicra e arriti kualifikimin si e dyta në grup ku mposhti Hungarinë, më pas barazoi me Skocinë dhe Gjermaninë. Edhe Italia u kualifikua si e dyta në grup ku së bashku ishte me Shqipërinë. Në ndeshjen e parë italianët e mposhtën kombëtaren e Shqipërisë, pastaj humbën nga Spanja dhe në ndeshjen e fundit arritën të barazojnë rezultatin në minutat shtesë ndaj Kroacisë (1-1), për ta arritur suksesin e

kualifikimit. "Këto ditë kanë qenë intensive. Goli ishte një emocion i madh. Natyrisht, ne nuk e dinim se duhej të barazonim për t'u kualifikuar, por për fat ia dolëm. Tani jemi të fokusuar vetëm në përgatitjen për një ndeshje vendimtare kundër Zvicrës. Ne e dimë se ekipi kombëtar mund të vuajë ndonjëherë, por shfaqet kur ka më shumë rëndësi. Kjo është pikërisht ajo që presim nga vetja", ka thënë Mattia Zaccagni. Sonte zhvillohet edhe një tjetër ndeshje nga ora 21:00. Do të përballen Gjermania dhe Danimarka. Gjermanët, që janë nikoqirë të këtij kompeticioni, arritën të kualifikohen të parët në grup, me dy fitore dhe një barazim. Në ndeshjen e tretë Gjermania shpëtoi nga humbja në minutat shtesë, pasi Zvicra ishte në pjesën më të madhe të kohës në epërsi. Në anën tjetër, Danimarka në Grupin C doli e dyta dhe me meritë siguroi kualifikimin. Denezët u kualifikuan me tri barazime në tri ndeshjet e zhvilluara.



FORMACIONET E MUNDSHME:

**Zvicra:** Sommer; Schar, Akanji, Rodriguez; Stergiou, Xhaka, Freuler, Aebischer; Ndoje, Embolo, Vargas.  
**Itali:** Donnarumma; Darmian, Mancini, Bastoni; Di Lorenzo, Barella, Jorginho, Cristante, Dimarco; Scamacca, Chiesa.

**Gjermania:** Neuer; Kimmich, Schlotterbeck, Rudiger, Mittelstadt; Kroos, Andrich; Musiala, Gundogan, Wirtz; Havertz.  
**Danimarka:** Schmeichel; Andersen, Christensen, Vestergaard; Bah, Hojbjerg, Delaney, Maehle; Eriksen; Hojlund, Wind.

## Dukagjini rikthen Millakun, transferon Krasniqin



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**KLINË, 28 QERSHOR** - Skuadra e Dukagjinit nga Klina po vazhdon përgatitjet për sezonin e ri futbollistik 2024/2025. Kjo skuadër e ka rikthyer mesfushorin Met Millaku derisa ka transferuar

Adonis Krasniqin. "Met Millaku kthehet në shtëpi. Millaku është lojtari më i ri i skuadrës sonë. Mesfushori 26-vjeçar rikthehet në shtëpinë e tij pas një sezoni të kaluar te Feronikeli '74 dhe Drenica", thuhet në njoftimin e Dukagjinit. Met Millaku i është bashkuar

tashmë ekipit në fazën përgatitore, për të qenë gati për sezonin e ri. Klubi nga Rrafshi i Dukagjinit ka njoftuar edhe për marrëveshjen e arritur me mesfushorin Adonis Krasniqi. "Ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje me futbollistin Adonis Krasniqi. 22-vjeçari bashkohet me klubin tonë nga

skuadra e Prizrenit, ndërsa më parë ka qenë pjesë e KEK-ut dhe Prishtinës së Re. Krasniqi luan në pozitën natyrale si mesfushor qendror", thuhet në njoftim. Skuadra e Dukagjinit në sezonin e ri futbollistik do të drejtohet nga trajneri Ismet Munishi, ndërsa do të jetë pjesë e garave ndërkombëtare.

## Hysaj: Kaloi përtej futbollit, u morën me flokët e mi

**TIRANË, 28 QERSHOR** - "Kaloi përtej futbollit", kështu është shprehur futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, për reagimin e furishëm në publik në lidhje me kokën e ulur në gjuajtjen e Nikolo Barellas në minutën e 16, me topin që më pas shkoi në rrjetë në ndeshjen Shqipëri - Itali. I ftuar në emisionin "Kampionët" në Tv Klan, Hysaj ka treguar emocionet dhe gjithçka që shkaktoi gjithë ai reagim i tifozëve shqiptarë

kundrejt tij. "Për mua kampionati ishte vërtet i çuditshëm dhe shumë i bukur. Më vjen keq që e mbyllëm pa një fitore sepse e meritonim. Jam i kënaqur. Edhe çunat ishin të kënaqur. Na ra një grup shumë i fortë. Të gjithë kishim besim se mund të kalonin, se mund të ndodhte një mrekulli. Si më ndodhi mua, mund t'i ndodhë dikujt tjetër. Unë jam i qetë me të vërtetë. Në karrierën time kam kaluar çaste të këqija dhe shumë të bukura.



Unë kam arritur ngadalë çdo shkallë. Jam lodhur për të arritur ku kam arritur dhe nuk besoj se një episod që mund të ndodhë... Kaloi përtej futbollit. Kritikat të gjithë i kemi pranuar. Doli jashtë

futbollit. U ekzagjerua pak si shumë", ka thënë Hysaj. "Unë direkt kam kthyer kokën, kur pashë që topi po hynte në rrjetë, direkt kam menduar se do të thonë njerëzit se ky u shmang. Po provoja që të ikja. Isha pak si i ulur, është një instinkt. Është një sekondë, është instinkt sepse pashë topin në moment të fundit dhe ula kokën. Nuk mundet një episod i tillë të ndodhë shumë shpesh në futboll... Kanë kaluar tepër futbollistë, janë marrë me

flokët e mia dhe me paraqitjen time. Unë kam djalin 8 vjeç. Sikur një fëmijë imi të ishte në rrjetet sociale, nuk do të ishte bukur. Unë nuk e kam problem. Unë vij për shtetin tim këtu. Më vjen keq që njerëzit mendojnë se vij në kombëtare për ta kaluar ditën. Reagoja për shkak të familjes. Ata janë të parët që më kanë mbështetur, babai im, djali dhe gruaja. E shikoja që kur flisja në telefon me prindërit e mi dhe më pyesin si je ti", ka deklaruar Hysaj.

## Fiorentina interesohet për Strakoshën

**FLORENCE, 28 QERSHOR** - Thomas Strakosha ishte një nga shumë gjërat pozitive që dhuroi Shqipëria në "Euro 2024". Gardiani kuqezi ishte një pikëpyetje e madhe, pasi vinte në këtë Evropian me shumë

pak minuta, por brenda kuadrantit, në të tre ndeshjet, Strakosha dhuroi paraqitje pozitive pavarësisht se pësoi 5 gola. Forma e tij shumë e mirë ka bërë që emri i Strakoshës të qarkullojë edhe një herë në

Serinë A. Sipas medieve italiane, Fiorentina ka shfaqur interesim për portierin kuqezi. Çuditërisht problem për një transferim të mundshëm te Fiorentina është agjenti i tij, pasi është edhe agjent i

Terraccianos, portierit aktual të Fiores. Është thuar se sigurt që Strakosha do të largohet nga Brentford, ndërsa Seria A mbetet opsion i preferuar, një kampionat që Strakosha e njeh shumë mirë.





## Sylvinho: Jam në pushime, pas një jave do të flas me stafin

PORTO, 28 QERSHOR - Shqipëria për të dytën herë brenda tetë vitesh ishte mes 24 skuadrave më të mira të Evropës, duke luajtur finalet e një kampionati evropian. Në një kontakt me "Top Channel", trajneri Sylvinho

dha këtë përgjigje, pyetjes nëse është drejt largimit nga menaxhimi i ekipit kuqezi. "Sapo kam arritur në Porto. Jam në pushime me familjen. Nuk di asgjë unë, se nuk kam folur me stafin (menaxherin). Do t'i

kontaktoj javën e ardhshme". Ajo që bie në sy është që oferta i është bërë përpara Evropianit dhe ai nuk ka gjetur asnjë ditë të ulet për ta diskutuar, por është shmangur nën justifikimin e ndeshjeve dhe angazhimit

me to. Me pak fjalë kombëtare tonë Sylvinho e sheh të sigurt, tashmë pret çfarë do t'i vijë deri më 9 korrik, deri atëherë nëse do të jetë federata e gatshme ta presë në këto manovra, jo shumë të qarta.



## LeBron James dhe djali i tij Bronny bëhen shokë skuadre

LOS ANXHELOS, 28 QERSHOR - Mëngjesin e së premtes u mbajt raundi i dytë i draftit të NBA-s në Barclays Center në Brooklyn, ku u shkrua historia, sepse Los Angeles Lakers draftuan Bronny James (19-vjeçar), i cili duhet të luajë me babain e tij të famshëm LeBron James (39-vjeçar). Bronny u zgjodh me zgjedhjen e 55-të nga Lakers pasi humbi një zgjedhje në raundin e parë të mërkurës, por tani ai dhe babai i tij do ta bëjnë historinë e NBA-s. Domethënë, të dy do të jenë baba e bir që do të luajnë së bashku në NBA për të njëjtin ekip dhe për herë të parë, duke përmbushur ëndrrën e kahershme të LeBroni. Lajmi u konfirmua nga faqja zyrtare e njërit nga klubet më të mëdha në NBA. Sipas ESPN, LeBron ishte "shumë emocionues" në momentin kur djali i tij u zgjodh nga lakersat dhe familja James u mbledh në Nju-Jork për një darkë ku ndoqi raundin e dytë të draftit të NBA-së. Gjithashtu, LeBron ka postuar në "Instagram" një foto me djalin kur ishte fëmijë me përshkrimin "trashëgimi".



Bronny vjen në NBA nga Universiteti i Kalifornisë Jugore, ku ai shënoi mesatarisht 4.8 pikë, 2.8 kërcime dhe 2.1 asistime në 19.4 minuta për lojë. 19-vjeçari ra në vëmendjen e publikut vitin e kaluar kur pati një sulm në zemër, i cili bëri që të bënte një pushim pesëmuor

por, për fat, u shërua dhe iu rikthye basketbollit. Nga ana tjetër, LeBron ka hyrë në vitin e fundit të kontratës me lakersat dhe ka afat deri të shtunës për të vendosur për statusin e tij për sezonin e ardhshëm, por është e sigurt që pas kësaj do të qëndrojë në Los Angeles.

## Versatappeni, besnik i Red Bullit

SPIELBERG, 28 QERSHOR - Këtë fundjavë gara e radhës e botërorit të Formulës 1 do të zhvillohet në pistën e Spielbergut në Austri, në shtëpinë e Red Bullit. Piloti holandez Max Verstappen, tri herë kampion bote me makinën austriake, ka zgjedhur pikërisht këtë pistë për të konfirmuar të ardhmen e tij (ka një kontratë deri në vitin 2028 me Red Bullin). "Të largohen nga Red Bull nëse nuk kanë më makinën më të mirë? Nuk mendoj se Formula 1 funksionon kështu. Nuk mund të thuash papritur 'lamtumirë djema'. Nuk funksionon kështu. Unë kam një kontratë të gjatë me ekipin dhe jam shumë i kënaqur me pozicionin në të cilin jam", ka thënë Verstappen. Pra, Verstappen ka vendosur të qëndrojë pavarësisht prej polemikave brenda skuadrës dhe zërave se mund të kalojë te Mercedesi: "Jemi duke u fokusuar



në vitin e ardhshëm dhe gjërat që mund të zbatojmë në makinë. Kështu që mendoj se kjo duhet të thotë mjaftueshëm se ku do të garoj vitin e ardhshëm". Duke folur për rivalitetin në pistë në garat e fundit, holandezi ka thënë: "McLareni është shumë solid për

momentin. Është i fortë kudo, por ne po përpiqemi fort të vazhdojmë të përmirësohemi. Kjo është ajo që ne do të përpiqemi të bëjmë tani dhe në garat e ardhshme, të cilat mendoj se janë shumë të rëndësishme për të kuptuar ku jemi".

### SHKURT

#### Gjilani nënshkruan me mesfushorin Sabit Bilali

SC Gjilani ka vazhduar përforsimet. Tash ka paraqitur mesfushorin shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Sabit Bilalin. Ai ka luajtur shumicën e karrierës në Maqedoni me klube si Shkupi, Shkëndija dhe Renova, ndërsa është paraqitur edhe te Partizani në Shqipëri. Sport Club Gjilani dhe futbollisti Sabit Bilali janë pajtuar për të qenë së bashku për dy edicionet e radhës. Mesfushori nga Tetova i është bashkuar ekipit në fazën përgatitore, derisa është vënë menjëherë në urdhrat e trajnerit Ardian Nuhiu. "26-vjeçari vjen pas një aventure të kaluar në klubin e Rabotniçkit në kampionatin e Maqedonisë së Veriut, kurse më parë ka mbrojtur edhe ngjyrat e klubeve tetovare, Shkëndija dhe Renova. Për dy sezone ishte pjesë e klubit tjetër shqiptar Shkupi, ndërsa karrierë ka bërë edhe në Superiore te Partizani i Tiranës. Bilali është pritur nga drejtori sportiv Ertan Demiri, i cili i ka uruar mirëseardhje futbollistit dhe i ka uruar shumë suksese në zgjedhjen e tij të re", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

#### Asani mund t'i bashkohet Las Palmasit

Tashmë mungon vetëm firma për ta quajtur zyrtare. Anësori i sulmit të Kombëtares, Jasir Asani, është gati për një rikthim të madh në Evropë, teksa pritet të largohet nga koreanët e Gwangjus menjëherë sapo të përfundojë Kampionati Evropian i Futbollit, Euro 2024, me 29-vjeçarin nga Shkupi, i cili e ka prerë tashmë "biletën". Sipas raportimeve më të fundit të prestigjiozes spanjolle "AS", Asani do të transferohet në La Liga, aty ku u pret skuadra e Las Palmasit, ekip që këtë sezon siguroi mbijetesën në elitën spanjolle dhe bordi i saj e pëlqen jo pak stilin e lojës të "legjionarit" dhe ka vendosur t'i ofrojë fillimisht një kontratë dyvjeçare. Spanjollja "AS" nuk është e vetmja që konfirmon këtë lajm. Edhe disa media të lidhura me klubin e Gwangjus, në Korenë e Jugut, kanë konfirmuar transferimin e tij dhe kanë ritheksuar faktin se gjithçka do të mbyllet sapo të mbarojë Evropiani.

#### Rudigeri drejt rikuperimit për sfidën ndaj Danimarkës

Pasi zuri vendin e parë në grupet e "Euro 2024", Kombëtarja e Gjermanisë përgatitet për ndeshjen e radhës, atë ndaj Danimarkës. Mbrojtësi i Real Madridit dhe Gjermanisë, Antonio Rudiger, është duke u rikuperuar pasi pësoi një tendosje të muskujve të kofshës gjatë ndeshjes 1-1 kundër Zvicrës. Siç raporton gazeta "AS", ai është rikthyer për të kryer disa ushtrime, por veçmas nga pjesa tjetër e ekipit. Ndonëse nuk është ende gati të stërvitet plotësisht me shokët e skuadrës, Rudiger po punon shumë për t'u rikuperuar sa më shpejt dhe për t'u rikthyer në fushë ndoshta kundër Danimarkës. Gjithsesi, duke parë se rivali nuk është shumë i fortë, të paktën në letër, ka gjasë që trajneri Julian Nagelsmann ta lërë lojtarin në stol, për ta aktivizuar në sfidat e radhës. Kjo, si një masë paraprake për të mos thelluar dëmtimin. Gjithsesi, situata do të monitorohet dhe do të vendoset pak para sfidës.

## Bellingham: E di që ka shumë negativitet, por ndiej se gjithçka është ndryshe në stadium

Pasi tërhoqi vëmendjen e të gjithëve me një sezon marramendës te Real Madridi, tani fokusi i Jude Bellingham është te "Euro 2024". Përveç golit të shënuar

ndaj Serbisë, talenti nuk arriti të ndikojë shumë në lojën e Anglisë, pavarësisht se kaloi në fazën e 1/8-ave. Në një situatë të tillë kritikave ndaj tij janë shtuar, por vetë

Bellinghami ndihet i qetë dhe këtë gjë e ka thënë edhe në prononcimin e dhënë për mediet në prag të ndeshjes ndaj Sllovakisë. "Mund të luash në një nivel që nuk

është më i miri, por gjëja më e rëndësishme është se kur vesh këtë emblemë dhe këtë fanellë, duhet t'i përfaqësosh bashkëkombësit dhe të mos dorëzohesh. E di që ka shumë

negativitet jashtë fushës dhe stadimeve, por gjithmonë ndiej se kur hyjmë në stadium është gjithçka ndryshe", ka deklaruar Bellinghami.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)


## RESTAURANT


# SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## LAJMËROJMË

Bashkëpronarët Akil Shabani, Xhulka Shabani, Ferit Shabani dhe Feriz Shabani, nga Fshat Lubizhdë, Komuna Prizrenit, si Blerësit potenciale, me Bashkëpronarët Marko Nikoliq, Angjela Nikoliq dhe Zorica Nikoliq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71813046-0161-7, sipërfaqe të përgjithshme prej 2994 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Lubizhdë, po i Shesim - pjesët tona bashkëpronësore.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. "Saracve" nr.49/A - Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 6.500 €/ar me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383-44-351-471

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kastriot Sedolli shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Katarina Lekaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " At Shtjefen Gjecovi " Zym.

- Ernest Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Vahide Sertilli shpall te pavlefshme dëftesat Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Bartësi Privat i Arsimit të Lartë  
Private Bearer of Higher Education



ALMA MATER EUROPAEA  
CAMPUS COLLEGE REZONANCA

Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Ref Nr AD-2804/24 datë 28.06.2024 Prishtinë

Në bazë të nenit 108 dhe 109 të Statutit dhe nenit 6 të Rregullores së studimeve të Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca", Senati në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2024 miratoi këtë:

## KONKURS

### Për pranimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2024/2025

Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca" në Prishtinë, në vitin e parë të studimeve, në programet e studimeve Bachelor dhe Master, në vitin akademik 2024/2025, do të regjistrojë studentët në programet e akredituara të paraqitura në tabelën vijuese:

Programet studimore të akredituara	Vendimi për akreditim	Nr. i studentëve
1. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	534/23, dt. 19.04.2023	85
2. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	928/22D, dt. 15.07.2022	50
3. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	928/22D, dt. 15.07.2022	60
4. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	1014/23, dt. 26.07.2023	120
5. Programi BSc Infermieri (180 ECTS)	Nga mbledhja 124 e KSHC dt. 25.06.2024	150
6. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	Nga mbledhja 124 e KSHC dt. 25.06.2024	100
7. Programi Master Fizioterapi dhe Mjekësi e Sportit (120 ECTS)	Nga mbledhja 124 e KSHC dt. 25.06.2024	30
8. Programi Master i Shkencave të Farmacisë (120 ECTS)	928/22D, dt. 15.07.2022	50

### KUSHTET E KONKURST

Në konkurs mund të paraqiten kandidatët që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- Të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme profesionale mjekësore të Kosovës, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet pa provim të maturës, që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme në shtete të tjera (duhet të paraqesin certifikatën dhe diplomën për kryerjen e shkollimit 12-vjeçar, në programet e të cilave kanë dëgjuar së paku një vit Biologji, Kimi dhe Fizikë, të nostifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës);
- të gjithë të graduarit ose të regjistruar në institucione të arsimit të lartë nga lëmenjtë e shkencave mjekësore, shkencave natyrore ose të shkencave të përafërta me programin.

Nëse kandidatët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet për lëndët Biologji, Kimi ose Fizikë sipas pikës një të paraparë në kushtet e konkursit, duhet të kalojnë vlerësimin plotësues nga ajo lëndë.

Në programet Master mund të paraqiten kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- kanë të përfunduar nivelin bachelor në programin adekuat të fushës (180 ECTS), të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e nivelit bachelor në programet e fushës të shteteve të tjera (aplikuesit shtetas të Republikës së Kosovës duhet të paraqesin diplomën për kryerjen e nivelit bachelor, të nostifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës)

Njohja e certifikatave, përkatësisht diplomave të jashtme do të bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

### MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Seleksionimi do të bëhet nëpër dy faza:

- Faza e parë: Vlerësimi akademik (vlerësimi i njohurive nga lëndët e paraqitura në tabelën në vijim).
- Faza e dytë: Vlerësimi i kualiteteve personale joakademike
  - vlerësimi i shkathtësive komunikuese dhe psiko-motorike;
  - vlerësimi i qëndrimeve dhe tipareve personale;
  - vlerësimi i personalitetit.

FAZA PARË: Vlerësimi akademik

- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
  - Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë
  - Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 70 pikë
- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
  - Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë
  - Suksesi në maturë vlerësohet deri në 20 pikë
  - Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 50 pikë

Provimi pranues sipas programeve mbahet nga lëndët e paraqitura në vijim:

Programi i studimit	Lëndët në provimin kualifikues
1. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
2. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
3. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
4. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë, Matematikë
5. Programi BSc Infermieri (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
6. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	Biologji, Fizikë

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret sukcesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kemi të njëjtën dukuri, zgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

FAZA E DYTË: Vlerësimi i kualiteteve personale joakademike

- Vlerësimi i shkathtësive komunikuese dhe psiko-motorike, qëndrimeve dhe tipareve personale, si dhe personalitetit.
- Vlerësimi kryhet nga psikologët e Kolegjit. Kandidatët që kalojnë fazën e parë dhe arrijnë 20% të pikëve të parapara, njoftohen për datën dhe terminin e vlerësimit në fazën e dytë përmes emailit.

Për studimet Master, kandidatët për regjistrim do të përzgjedhen në bazë të këtyre kriterëve:

- Suksesi gjatë studimeve në nivelin bachelor (nota mesatare e studimeve) = max. 60 pikë
- Publikimeve, pjesëmarrjeve në kongrese/konferenca/takime profesionale dhe aktivitetet të tjetër kërkimore-shkencore = 10 pikë
- Trajnime, kurse të tjera të kryera = 20 pikë
- Njohja e Gjuhës Angleze (të dëshmuar me certifikatë/diplomë = 10 pikë

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit gjatë studimeve bachelor nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kemi të njëjtën dukuri, zgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

### AFATET E KONKURST

Paraqitja e dokumenteve fillon nga data **01 korrik 2024**, prej orës **09:00-19:00**.

Për afatin e parë, provimi pranues do të mbahet më **24 korrik 2024**, sipas këtij orari:

Termi	Programi
10:00	Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)
11:00	Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)
11:00	Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)
12:00	Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)
13:00	Programi BSc Infermieri (180 ECTS)
14:00	Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)

Paraqitja e dokumenteve për afatin e dytë të konkursit zgjatë deri më **23 shtator 2024**, kurse provimi pranues për afatin e dytë do të mbahet më **25 shtator 2024**, në orën **10:00**.

Paraqitja e dokumenteve për studimet Master bëhet deri më **04 nëntor 2024**.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca".

Për paraqitje në konkurs kandidatët duhet të sjellin:

- Certifikatën e lindjes
- Dëftesat e shkollës së mesme;
- Diplomën e shkollës së mesme;
- Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).
- Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Kopjen e leternjoftimit

Për paraqitje në konkurs për studimet Master kandidatët duhet të sjellin:

- Certifikatën e lindjes.
- Diplomën Bachelor (me 180 ECTS).
- Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).
- Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Kopjen e leternjoftimit.
- Dëshmitë lidhur me publikimet shkencore (kopjet).

- Dëshmitë lidhur me trajnimet tjera (certifikatë/diplomat).
- Dëshmitë për testin e gjuhës angleze (certifikatë/diploma).

Me rastin e paraqitjes në konkursin për pranim kandidatët paguajnë 15 Euro.

Në të gjitha fazat e procedurës së pranimit kandidatët me vete duhet të sjellin dokumentin e identifikimit.

Kandidatët e pranuar, për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletë-aplikacionin për regjistrim (i cili merret në Institucion);
- Një fotografi të formatit 4.5 x 6 cm;
- Fletëpagesën për këstin e parë të pagesës së studimeve.

Me rastin e regjistrimit kandidatët e nënshkruajnë Kontratën me Kolegjin.

Kandidatët mund të informohen nëpërmjet:

- Informatorit të AMECCR për vitin akademik 2024/2025 (merret në Kolegji)
- Tel. 038-544-754, prej orës 09:00 deri 19:00
- E-mail: [info@rezonanca-rks.com](mailto:info@rezonanca-rks.com)
- Web-faqës: [www.rezonanca-rks.com](http://www.rezonanca-rks.com)





# TRADITË QË NGA

# 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

